



Projekti EPIC: Qytetaria Sipërmarrëse për Ndryshim Social

Fuqizimi i Ndryshimit Social: Krijimi i Toolkit (paketës së mjeteve) EPIC për Të Rinjtë dhe Punonjësit Rinorë

Një set i ri burimesh të specializuara, Toolkit-et EPIC (<https://epic-project.eu/courses/toolkit-for-youth-workers/>), janë prezntuar zyrtarisht për të mbështetur zhvillimin e sipërmarrjes sociale në Ballkanin Perëndimor. Këto toolkit-e (paketë mjeteve) ofrojnë një udhërrëfyes praktik për të rinjtë inovatorë dhe edukuesit për të kthyer sfidat sociale në iniciativa sipërmarrëse të qëndrueshme.

Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj inovacionit social

Toolkit-et u zhvillun për të mundësuar zbatimin praktik të Kurrikulës EPIC, duke përdorur metodologji të mësimi jo-formal për të nxitur një mendësi inovacioni social. Burimet janë të ndara në dy grupe të veçanta:

- **Toolkit për të rinjtë:** Fokusohen në zhvillimin e kompetencave kyçe si lidërshipi, mendimi etik dhe identifikimi i mundësive. Udhëzon të rinjtë përmes hapave praktikë të krijimit të një Modeli Canvas të Biznesit Social dhe realizimit të analizave SWOT për zgjidhjen e çështjeve të komunitetit.
- **Toolkit për punonjësit rinorë:** Pajis punonjësit rinorë me strategji të avancuara mentorimi dhe këshillimi. Thekson

rëndësinë e inteligjencës emocionale dhe drejtësisë sociale, duke ndihmuar punonjësit rinorë të ofrojnë mbështetje të strukturuar për të rinjtë sipërmarrës.

Ndikimi

Efektiviteti i këtyre mjeteve u vërtetua gjatë zbatimeve pilot, ku ato morën vlerësime të larta për qartësinë dhe dobishmërinë e tyre:

- **Kosovë:** 100% e të rinjve pjesëmarrës e gjetën përmbajtjen shumë të qartë dhe të lehtë për t'u kuptuar. Trajnimi arriti të angazhojë një grup të larmishëm, me 83% të aplikantëve vajza.
- **Shqipëri:** Kurrikula dhe mjetet mundësuan që pjesëmarrësit të lidhen me sipërmarrje sociale reale, si p.sh. New York Tirana Bagels. Për pasojë, 85.7% e punonjësve rinorë pjesëmarrës shprehën nivelin më të lartë të kënaqësisë.
- **Bosnje dhe Hercegovinë:** Toolkit-et ofruan ekspozimin e parë të strukturuar ndaj sipërmarrjes sociale për shumë pjesëmarrës, duke i ndihmuar të tejkalojnë qasjen tradicionale “humanitare” dhe të adoptojnë një perspektivë të bazuar në vlera dhe biznes.

Aftësi të qëndrueshme për të ardhmen

Edhe në rajone që mungon një kuadër ligjor formal për sipërmarrjet sociale, Toolkit-et EPIC fuqizojnë pjesëmarrësit për të vepruar në mënyrë efektive, duke u fokusuar te Korniza Europiane EntreComp. Duke lidhur punën sociale me veprimet sipërmarrëse, këto burime sigurojnë që gjenerata e ardhshme të jetë e përgatitur për të udhëhequr inovacionin e qëndrueshëm me fokus në komunitet.

Për më shumë informacion rreth projektit EPIC dhe për të qëndruar të përditësuar me aktivitetet tona, vizitoni faqen tonë të internetit **epic-project.eu** ose na kontaktoni në epic-project@kmop.org.



**Funded by
the European Union**

The European Commission's support for the production of this publication does not constitute an endorsement of the contents, which reflect the views only of the authors, and the Commission cannot be held responsible for any use which may be made of the information contained therein. [Project Number: ERASMUS-YOUTH-2023-CB]